



INTERNATIONAL MONETARY FUND



Njoftim për shtyp 17/17
24 janar 2017

Fondi Monetar Ndërkombëtar
Washington, D.C. 20431 USA

FMN arrin marrëveshje në nivel stafi për përfundimin e shqyrtimit të nëntë dhe të dhjetë të Marrëveshjes së Fondit të Zgjeruar për Shqipërinë

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), nën drejtimin e zonjës Anita Tuladhar, vizitoi Tiranën gjatë periudhës 18-24 janar 2017, për të zhvilluar diskutime për shqyrtimin e nëntë dhe të dhjetë të Marrëveshjes së Fondit të Zgjeruar (EFF) për Shqipërinë.

Në përfundim të vizitës, zonja Tuladhar mbajti këtë deklaratë:

“Ekipi i FMN-së arriti një marrëveshje në nivel stafi me autoritetet e Shqipërisë, për politikat që nevojiten për të përfunduar shqyrtimin e nëntë dhe të dhjetë të EFF-së. Misioni diskutoi edhe për prioritetet e politikave në kuadër të Monitorimit pas Programit. Programi ekonomik vazhdon të ecë sipas planit dhe i ka arritur objektivat bazë të korrigjimit të çekuilibrave të mëdhenj makroekonomikë dhe të fuqizimit të rritjes ekonomike. Janë përmbushur shumica e objektivave të synuar sasiorë. Pavarësisht nga disa vonesa, është arritur një progres përgjithësisht i mirë në vënien në zbatim të reformave strukturore.

“Programi e ka vendosur ekonominë shqiptare në rrugën drejt financave publike solide, stabilitetit financiar dhe rimëkëmbjes ekonomike. Me mbylljen e programit, do të jetë thelbësore që Shqipëria të angazhohet për vazhdimin e reformave ekonomike. Këto reforma janë me rëndësi jetike për rritjen e besimit, nxitjen e investimeve dhe fuqizimin e perspektivës për rritje. Rekomandimi me kusht i kohëve të fundit për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE shënon një moment të rëndësishëm, sepse njeh angazhimin e autoriteteve në këtë proces të reformave.

“Ekipi i FMN-së parashikon fuqizim të ekonomisë. Rritja e PBB-së pritet të ketë arritur në 3,4 për qind në vitin 2016 dhe parashikohet të përshejtohet në rreth 4 për qind në periudhën afatmesme, e mbështetur kryesisht tek investimet e mëdha të huaja të direkte të lidhura me energjetikën dhe të një rritje e kërkesës së brendshme. Vitin që shkoi inflacioni mesatar arriti 1,3 për qind, në përputhje me kërkesën e brendshme në rritje, si dhe pritet të vijojë të rritet gradualisht derisa të arrijë normën e synuar prej 3 për qind në vitin 2018. Defiçiti i llogarisë

korrente pritet të zgjerohet për shkak të nivelit të lartë të importeve që nevojiten për projektet e sektorit energjetik, nga rreth 12 për qind e PBB-së në 13,5 për qind e PBB-së në 2017-2018.

“Të dhënat paraprake tregojnë se buxheti i vitit 2016 ka arritur një balancë primare pozitive, diçka më pak se niveli i programuar. Të ardhurat ishin nën plan, kryesisht për shkak të rënies së arkëtimeve nga tatimi mbi vlerën e shtuar, ndërsa realizimi i shpenzimeve u përmirësua ndjeshëm me afrimin e fundit të vitit. Borxhi publik ka filluar rënien, por mbetet i lartë në nivelin mbi 70 për qind të PBB-së. Për të arritur objektivin afatmesëm për borxhin, autoritetet kanë rënë dakord të synojnë arritjen e një balance primare prej 0,7 për qind të PBB-së në buxhetin e vitit 2017, si edhe të kursejnë të ardhurat e njëhershme të paplanifikuara në buxhet, prej rreth 0,5 për qind të PBB-së.

“Qëndrimi për një politike monetare akomoduese nga ana e Bankës së Shqipërisë është i duhur dhe përputhet me objektivin e saj për stabilitetin e çmimeve. Sistemi bankar mbetet i qëndrueshëm, likuid dhe i kapitalizuar mirë. Kredia për individët po e rimerr veten, por stoku i kredive nën standard, që vijon të jetë i lartë në nivelin mbi 20 për qind të kredive, po frenon huadhënien për bizneset. Me rëndësi parësore për zgjidhjen e kredive nën standard është zbatimi i ligjit për falimentin, dhe ligjit për përmbaruesit privatë.

“Sa i takon së ardhmes, rekomandohen këto prioritetë: të vijohet zgjerimi i të ardhurave për të fuqizuar financat publike dhe për të siguruar qëndrueshmërinë në kohë të borxhit; të ulet niveli i kredive nën standard për të fuqizuar stabilitetin financiar dhe për të mbështetur rimëkëmbjen e huadhënies; dhe të çohen përpara reformat strukturore për të përmirësuar klimën e biznesit. Në këto fusha është arritur progres i rëndësishëm por nevojitet të punohet më tej për t’i çimentuar këto arritje. Në këtë aspekt, objektiva të rëndësishëm mbeten fuqizimi i administratës tatimore, zgjerimi i bazës tatimore dhe zbatimi i një tatimi mbi pronën me bazë vlerën. Përmirësimi i drejtimit financiar publik do të ndihmojë në sigurimin e shpenzimeve publike më efikase dhe në mbajtjen në kontroll të detyrimeve të prapambetura. Nevojitet një zbatim i shpejtë i strategjisë për zgjidhjen e kredive nën standard për të fuqizuar huadhënien për sektorin privat. Për të rritur aftësinë konkurruese me rëndësi kritike do të jenë reformat strukturore për përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit, zgjidhjen e mangësive infrastrukturore dhe rritjen e kualifikimit të krahut të punës.

“Bordi Ekzekutiv i FMN-së pritet të diskutojë për shqyrtimin e nëntë dhe të dhjetë në shkurt 2017. Aprovimi i shqyrtimit do të mundësonte lëvrimin e 57.28 milion SDR (rreth 72.4 milion euro). Programi 36-mujor në formë EFF-je për Shqipërinë është miratuar më 28 shkurt 2014 (shih [Njoftimin për shtyp nr.14/81](#)).”